



BULETINI ELEKTRONIK I SHOQATËS UJËSJELLËS KANALIZIME TË SHQIPËRISË



SHUKALB
SHOQATA UJËSJELLËS KANALIZIME E SHQIPËRISË

Shkurt 2016

Reforma në Sektorin e Ujit

Vendim i Këshillit të Ministrave mbi Riorganizimin e Operatorëve që ofrojnë Shërbimin e Furnizimit me Ujë të Pijshëm, Grumbullimin, Largimin dhe Trajtimin e Ujërave të Ndotura



Qeveria e Shqipërisë ka nisur një reformë totale në fushën e qeverisjes dhe menaxhimit të integruar të ujit. Pjesë thelbësore e këtij sistemi total të integruar të

menaxhimit të ujit është dhe nënsektori i furnizimit me ujë dhe largimit të ujrave të ndotur. Në kuadër të reformës territoriale administrative lind nevoja për riorganizimin e këtij sektori dhe të nevojës për një performancë sa më të mirë të sektorit.

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës së bashku me Ministrinë e Shtetit për Çështjet Vendore, ndërmorën nismën për hartimin e një projekt vendimi “Për Riorganizimin e Operatorëve që Ofrojnë Shërbimin e Furnizimit me Ujë të Pijshëm, Grumbullimin, Largimin dhe Trajtimin e Ujërave të Ndotura”, i cili u miratua nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë më datë 27 Janar 2016. [lexo më shumë](#)

Çfarë ka të Re në SHUKALB?

SHUKALB Organizon Takime Rajonale me Shoqëritë Ujësjetllës Kanalizime



Rreth SHUKALB

Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë (SHUKALB), e themeluar në vitin 2000, është një Shoqatë profesionale, jofitimprurëse e profesionistëve në sektorin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, e cila synon të përmirësojë menaxhimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve në Shqipëri, për ta bërë atë më eficient, të qëndrueshëm dhe efektiv në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në Shqipëri...

Eventet e Ardhshme!

Mbledhja e Asamblesë - Shkurt 2016

Programet e Ardhshme!

-Dita Botërore e Ujit –
22 mars 2016
-Programi Miqtë e Ujit –



Në përputhje me statutin e saj, SHUKALB ndërmori një proces për zgjedhjen e anëtarëve të rinj në Bordin e saj të Drejtorëve për mandatin tre vjeçar, 2016-2018. Për

kryerjen e procesit të votimit dhe për të qenë sa me afër anëtarëve, SHUKALB organizoi katër takime rajonale me shoqëritë UK anëtare të saj, në Tiranë, Lezhë, Vlorë dhe Korçë. Në përpjekje për të arritur një grup sa më të gjerë aktorësh, në dritën e reformës territoriale administrative që hyri në fuqi në vitin 2015, si dhe reformave të sektorit të ujit që u miratuan së fundmi nga Qeveria, SHUKALB zgjeroni ftesat edhe për shoqëritë UK jo-anëtare në rajonin e takimit, si dhe për përfaqësues të pushtetit lokal në të njëjtin rajon. [lexo më shumë](#)

SHUKALB Fillon Dhënien e Kurseve të Trajnimit

Kanë filluar regjistrimet për kurset e trajnimeve që SHUKALB organizon për stafin e shoqërive Ujësjetllës Kanalizime dhe personat e tjerë të interesuar. Kurset do të zhvillohen në Tiranë dhe nisin në muajin mars. Për regjistrime, ju lutem të kontaktoni në adresën e e-mailit: training@shukalb.al ose në cel: 069 70 81 515. [lexo më shumë](#)

Lajme nga Anëtarët tanë

Qeveria Nënshkruan Marrëveshjen për Ndërtimin e Linjës së Re të Furnizimit me Ujë për Ujësjetllës Kanalizime Durrës



Drejtorja e Përgjithshme e Ujësjetllës Kanalizimeve (DPUK) dhe firma gjermane "PWT", kanë firmosur marrëveshjen për ndërtimin e linjës së re të furnizimit me ujë dhe sistemit

të transmisionit për shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Durrës. Marrëveshja u nënshkrua nga drejtori i DPUK-së, Z. Ardian Alushi dhe përfaqësuesi i firmës "PWT". Gjithashtu të pranishëm gjatë nënshkrimit ishin dhe Ministri i Transporteve dhe Infrastruktura, Z. Edmond Haxhinasto, Drejtori i Përgjithshëm i Ujësjetllës Kanalizime Durrës sh.a, Z. Spartak

mars 2016
-Sfida Botërore e Monitorimit të Ujit – mars 2016
-Programi i Praktikës së Punës – mars 2016

Bashkohuni me Ne!



Na tregoni se cfarë mendoni!



Kovaçi, si dhe përfaqësuesi lokal i Bankës Botërore, e cila siguroi financimin e investimit, Z. Artan Guxho.[lexo më shumë](#)

Aplikimi i Matësave Inteligjentë Elektro-magnetik në Stacionet e Prodhimit të Ujit të Shoqërise Ujësjetllës Elbasan Fshat



Në kuadër të projektit “WASSP” të bashkë-financuar nga BE – Austri, shoqëria Ujësjetllës Elbasan Fshat përfitoi një grant që i ndihmoi të adresonin mungesën e monitorimit të

saktë (matjes) të ujit të pijshëm të prodhuar nga stacionet e pompimit saj. Menjëherë pas marrjes së grantit, shoqëria në konsultim me specialistët e “WASSP”, inspektuan çdo stacion të pompimit në terren. Të dyja palët arritën në konkluzionin se në mënyrë që investimi të ishte i suksesshëm, nevojitej të vendoseshin matësua inteligjentë elektro-magnetik të prurjes së ujit, të cilët kanë një precizion të lartë.[lexo më shumë](#)

Të tjera

Bashkitë Model me Plane Tranzitore për Shërbimin Ujësjetllës-Kanalizime



Reforma Administrative-Territoriale do të sjellë ndryshime të mëdha në shërbimin ujësjetllës-kanalizime brenda kufijve të të gjitha NJQV-të reja në Shqipëri. Para reformës, shërbimet e furnizimit me ujë në

zonat urbane ofroheshin nga një ndërmarrje në varësinë e Këshillit Bashkiak, ndërsa zona rurale ka pasur disa forma organizimi për menaxhimin e këtyre shërbimeve, si vetë ujësjetllësi apo komuna, ose njerëz që vullnetarisht administronin sistemin e furnizimit me ujë. Historikisht, zonat rurale nuk mbuloreshin plotësisht me shërbimin e furnizimit me ujë dhe ndërmarrjet që veprojnë në territorin e tyre nuk janë financiarisht të qëndrueshme.[lexo më shumë](#)

Arlinda Ibrahimllari, UK Korçë, Operatorja e Parë Profesioniste e Certifikuar Jashtë SHBA



SHUKALB është krenar të shpallë suksesin e arritur nga Znj Arlinda Ibrahimllari për fitimin e certifikimit si Operator Profesional në kategorinë e Trajtimit të Ujërave të Ndotur, e

dhënë nga Shoqata e Bordeve të Certifikimit (ABC) në Ankeny, Iowa, SHBA. Arlinda është personi i parë jashtë SHBA-ve që fiton certifikimin si Operator Profesional, e administruar nga ABC. [lexo më shumë](#)

Trajnime dhe Mundësi Arsimimi

Programi i Përbashkët Japoni / Banka Botërore për Bursat e Diplomimit

Programi i Përbashkët Japoni / Banka Botërore për Bursat e Diplomimit (PPJBBBD) do të fillojë me pranimin e aplikimeve në datë 10 Shkurt 2016. Programi është i hapur për gratë dhe burrat të vendeve në zhvillim me përvojë profesionale dhe me një histori në mbështetje të përpjekjeve për zhvillimin e vendeve të tyre. Më shumë informata mund të gjenden duke ndjekur linkun: <http://go.worldbank.org/NV4RFT1BP0>

[Anëtarësohuni në SHUKALB](#)

[Kurset e Trajnimit](#)

[Na kontaktoni](#)

Shoqata Ujësjetës Kanalizime e Shqipërisë,

Rruga "Pjeter Bogdani", Nd. 17 Ap. 25, Njësia Bashkiake Nr. 5, Kodi Postar 1019, Tirane, Shqiperi

Tel/Fax: (+355/4) 2245 101, Mob: (+355) 69 60 12 782

E-mail: info@shukalb.al, Web: www.shukalb.al